

Fusha e ndërhyrjes : ARSIMI DHE NXITJA E DIALOGUT NDËRKULTUROR						
Objektivi Strategjik	Arsimim në cilësor për anëtarë të pakicave Rome dhe Egjiptiane dhe anëtarë të familjeve të kthyer nga emigrimi në Bashkinë Berat					
Objektivi 1	Rritja e numrit të fëmijëve të pakicave rome dhe egjiptiane përfshirë dhe atyre të kthyer nga emigrimi që ndjekin sistemin arsimor në të gjitha nivelet (parashkollorë, bazë, të mesëm dhe të lartë)					
Rezultatet e pritshme:	i. Deri në fund të 2025, 50% me shumë fëmijë të pakicave Rome dhe Egjiptiane dhe 30% më shumë fëmijë të kthyer nga emigrimi apo azili ndjekin arsimin bazë dhe arsimin e mesëm në Bashkinë Berat në krahasim me vitin 2022;					
Treguesit:		Baseline 2021	Target 2022 Kumulative	Target 2023 Kumulative	Target 2024 Kumulative	Target (2025) Kumulative
	Numri i fëmijëve R/E që braktisin shkollën ose që rrezikojnë të braktisin arsimin e detyrueshëm të referuar çdo vit në shërbimet e mbrojtjes sociale dhe burimet e tjera mbështetëse	21 fëmijë R/E 17 (Egjiptian dhe 4 rom )  Shkollat ku ka braktisje: Shyqri Lakra , Xhemal Cekini, Shkolla e Bashuar Morave	15 fëmijë	10 fëmijë	5 fëmijë	0
	7 shkolla në Bashkinë Berat funksionojnë si SHQK  “ Babë Dudë Karbunara”, e mesme e bashkuar “ Shqyqyri Lakra”, 9-vjeçare “ Mehmet Ali Vrioni”, 9-vjeçare “ 22 Tetori”, 9-vjeçare “ Zihni Toska”, 9-vjeçare “ 1 Maji” dhe shkolla e mesme e bashkuar artistike “ Ajet Xhindole	7	8	9	10	11
	Numri i fëmijëve R/E të cilët mbështeten në përgatitjen e detyrave të shtëpisë në shkollë.  Ndarë sipas gjinisë, etnisë, të kthyer nga emigrimi apo azili, moshë	30	50	85	110	13
	Numri i prindërve R/E të cilët janë informuar në lidhje me martesat e hershme të vajzave rome dhe egjiptiane.	220 prinder romë dhe egjiptianë	240 Do rritet 10% çdo vit do shtrihet edhe	490	750	1000

	Ndarë sipas gjinisë, etnisë, të kthyer nga emigrimi apo azili, moshë		ne njesine administrative Otlak			
	**Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë të përjashtuar nga tarifat për ndjekjen e arsimit parashkollor.	90 fëmijë (85 Egjiptian, 5 Romë)	110	220	330	440
	Qendra komunitare nderkulturore funksionon si “after school” për fëmijët Rom dhe Egjiptianë	0	0	1	1	1
	Numri i aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuese të zhvilluar me prindërit për të parandaluar martesat e hershme të vajzave romë dhe egjiptiane.	20 aktivitete	26 aktivitete	52	78	110

MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR	Financimi		
					Bashkia	Qeveria Qendrore	Donatorë
<p>1.1 Sigurim i transportit falas për nxënësit romë dhe egjiptianë të cilët banojnë larg kopshteve dhe shkollave (edhe nën distancën 2km për raste specifike të justifikuar) dhe lehtësimi i procedurave për transfertën e shpenzimeve të transportit. Janë 20 fëmijë në ish-Pjeshkore që nuk frekuentojnë shkollën sepse kanë problem transportin</p>	<p>Të gjithë fëmijët rom dhe egjiptianë do të përfitojnë transport falas deri në fund të 2025.</p> <p>Gjatë vitit 2021 prane zonave ku ka komunitete, shkolla me e afert është 500 m. Nuk ka <i>qenë</i> i nevojshem transporti.</p> <p>Vendim <b>Nr.682, datë 29.7.2015</b> “Për përdorimin e Fondeve Publike për transportimin e punonjësëve arsimorë që punojnë dhe të nxënësëve që mësojnë jashtë vendbanimit” është rishikuar dhe janë përcaktuar kriteret për rastet specifike që nuk përmbushin distancën 2km, gjithashtu është ripërcaktuar mënyra e kalimit të transfertës financiare për</p>	MAS	Bashkia Berat	2022-2025	0	0	0

	shërbimin e transportit direkt tek prindërit e fëmijëve.						
1.2 Referimi i familjeve të fëmijëve që braktisin shkollën ose që rrezikojnë të braktisin arsimin e detyrueshëm në shërbimet e mbrojtjes sociale dhe burimet e tjera mbështetëse. Lista e fëmijëve që braktisin shkollën dihet të jetë në dispozicion të Bashkisë nga ZVA	Skeme nxitëse, mbështetëse dhe detyruese aplikuar nga Bashkia Berat për përfundimin e arsimit bazë.  Është rritur me 20% numri i familjeve të referuara në shërbimet e mbrojtjes sociale ose në burimet e tjera të mbështetjes, llogaritur mbi realizimin baseline të vitit 2022.	NJMF	Bashkia Berat	2022-2025	18,480.00	18,480.00	55,440.00
1.3 Ndërgjygesimi dhe krijimi i lehtësive për frekuentimin e çerdheve nga fëmijë të pakicave R&E dhe atyre të kthyer nga emigrimi apo azili	Regjistrimit të të gjithë fëmijëve romë dhe egjiptianë 3-6 vjeç në arsimin parashkollor duke i përjashtuar ata nga tarifat financiare dhe pagesat për ushqim.)  Bashkia Berat ka nje pakete qe subvencionon plotesisht.	Bashkia Berat	Bashkia Berat	2022-2025	220,000.00	220,000.00	0.00

1.4 Regjistrimi falas në arsimin e mesëm për nxënësit Rome dhe Egjiptianë	Bashkia Berat përgatit një paketë ndihme financiare për të gjithë nxënësit R&E të cilët regjistrohen në arsimin e mesëm	Bashkia Berat	Bashkia Berat	2022-2025	0	0	0
1.7 Informimi i komunitetit Rom dhe Egjiptian për mundësinë e bursave në sistemin arsimor nëpërmjet sesioneve informuese	Sesione informimi në komunitet	DAR Shkollat	Bashkia Berat	2022-2025	Shih 1.3		
1.8 Funksionimi i SHQK (Shkolla si Qendër Komunitare në 7 shkolla 9-vjecare ) në Bashkinë Berat.	Standartet e SHQK të miratuara me vendim të Minsitrit të Arsimit dhe Sporteve date 13 mars 2014. Shkolla Qendër Komunitare, një shkollë miqësore për të gjithë është një qasje (levizje promovuese dhe zhvilluese) për ta kthyer shkollën në vendin ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet dhe bashkëpunohet për zhvillimin e potencialit të plotë të çdo nxënësi 7 shkolla në Bashkinë Berat funksionojnë si SHQK.	Bashkia Berat	Bashkia Berat, OSHC lokale ose ndërkombëtare	2022-2025			
					0.00	1,026,000.00	4,104,000.00

1.9 Në Shkollat Qendër Komunitare lehtësimi dhe organizimi i përgatitjes së detyrave të shtëpisë në shkollë për nxënësit rome dhe egjiptianë .	Të gjithë nxënësit Rom dhe Egjiptianë marrin pjesë në projektin për përgatitjen së detyrave të shtëpisë në shkollë.	Shkollat	Bashkia Berat	2022-2025			
1.10 Zhvillimi dhe azhurnimi (me pjesëmarrjen e komunitetit Rom dhe Egjiptian) i listës së shërbimeve që shkollat qendër komunitare i ofron komunitetit rome dhe egjiptian dhe të kthyerve nga emigrimi dhe azili.	Cdo vit lista e shërbimeve të ofruara nga SHQK-të hartohet përmes një procesi me pjesëmarrje të anëtareve të komunitetit bazuar në nevojat e tyre.	SHQK	SHQK, Bashkia Berat	2022-2025	0.00	132,000.00	0.00
1.11 Sigurimi i teksteve falas për nxënësit Rome dhe Egjiptianë të cilët ndjekin arsimin e mesëm	Mbështetje financiare nga bashkia Berat për sigurimin e teksteve falas për fëmijët R&E të cilët ndjekin arsimin e mesëm.	Bashkia Berat	Bashkia Berat	2022-2025	0	0	0
1.12 Vendosija e masave dhe detyrimeve për familjet që përfitojnë nga bonusi i qerasë për të dërguar fëmijët në kopshte dhe shkollë	Cdo familje rome dhe egjiptiane që përfiton nga skemat e strehimit social kanë detyrim të dërgojnë fëmijët e tyre në kopshte dhe shkolla.	Bashkia Berat	Bashkia Berat, ZVA, shkollat	2022-2025	0	0	0
1.14 Informimi dhe ndërgjegjësimi të prindërve për të parandaluar martesat e hershme të vajzave rome dhe egjiptiane.	Aktivitete infirmimi dhe ndërgjegjësimi me prindër rom dhe egjiptian në lidhje me martesat e hershme. Ketu	Bashkia Berat	Shkollat OSHC	2022-2025	150,000.00	0.00	600,000.00

	përfshihen biseda në kounitet, takime dere më derë etj.						
1.16 Sigurimi i ngrohjes dhe sigurisë në shkollën Shaban Sollaku në Otlak	Shkolla Shaban Sollaku në Otlak të jetë në kushte optimale të funksionimit dhe sigurisë	Bashkia Berat	Bashkia Berat	2022	200,000.00	0.00	0.00

Fusha e ndërhyrjes : ARSIMI DHE NXITJA E DIALOGUT NDËRKULTUROR						
<b>Objektivi Strategjik</b>	Arsimim më cilësor për anëtarë të pakicave Rome dhe Egjiptiane dhe familjeve të kthyer nga emigrimi apo azili në Bashkinë Berat					
<b>Objektivi 2</b>	Përmirësimi i rezultateve në mësimet e fëmijëve Rom dhe Egjiptian dhe atyre të kthyer nga emigrimi apo azili përmes monitorimit të performancës në shkollë dhe arsimimit më të mirë të prindërve të tyre					
<b>Rezultatet e pritshme:</b>	i. Deri në fund të 2025, 20% me shumë fëmijë të pakicave Rome dhe Egjiptiane përfundojnë arsimin bazë dhe arsimin e mesëm në Bashkinë Berat në krahasim me vitin 2022;					
<b>Treguesit:</b>		Baseline 2021	Target 2022 Kumulative	Target 2023 Kumulative	Target 2024 Kumulative	Target (2025) Kumulative
	Numri i kurseve kundër analfabetizimit të organizuar për prindër R/E dhe të kthyer nga emigrimi apo azili	0	1	3	5	7
	Numri i prindërve romë dhe egjiptianë dhe të kthyer nga emigrimi apo azili dhe që janë regjistruar si PuPa të cilët kanë përfituar nga kurset e analfabetizimit . Ndarë sipas gjinisë, etnisë, të kthyer nga emigrimi apo azili, grupmosha	0	50	100	150	150
	Numri i takimeve drejtë me drejtë, sesione informimi në grupe me prindër (kryesisht nëna) Rome dhe Egjiptiane të zhvilluara mbi rëndësinë e arsimimit të fëmijëve të tyre.  Ndare sipas : takime drejtë me drejtë, sesione informuese, takime individuale etj	24 takime	24	48	75	100
	Numri i shkollave në bashkinë Berat në bordet e të cilave janë të përfshirë prindër nga komuniteti R/E	15	15	31	47	64
	Numri i kampeve verore me programe mesimore dhe aktivitete të ndryshme të zhvilluara në qendrën komuniare nderkulturore.	0	1	2	3	4



--	--	--	--	--	--	--

MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR	Financimi		
					Bashkia	Qeveria Qendrore	Donatorë
2.1 Ngritja e grupit monitorues të frekuentimit të rregullt të shkollës nga fëmijët romë dhe egjiptianë dhe atyre të kthyer nga emigrimi, i përbërë nga drejtor shkolle, mësues kujdestar, psikolog, punonjës social, ndërmjetësues komuniteti) për frekuentimin e shkollës	Grupi monitorues i ngritur dhe funksional	ZVA	Bashkia Berat, DAR	2022	0	0	0
2.2 Organizimi i kurseve kundër analfabetizmit në qendrën komunitare nderkulturore për prindërit rome dhe egjiptianë dhe të kthyer nga emigrimi apo azili	50 prindër rome dhe egjiptianë marrin pjesë çdo vit në kurset kundër analfabetizmit të organizuara në qendrën komunitare	SHQK	Bashkia Berat, OSHC lokale	2022-2025	462,000.00	0.00	1,848,000.00
2.3. Informimi dhe ndërgjegjësimi i prindërve rome dhe egjiptianë mbi rëndësinë e arsimit të fëmijëve të tyre	Takime dre me dre, sesione informimi ne grupe me prindër (kryesisht nëna) Rome dhe Egjiptiane mbi rëndësinë e arsimit të fëmijëve të tyre. Në këto masa do të përfshihen edhe mediatorët rome për arsimin si dhe kryepleqt në çdo lagje/njësi administrative	Bashkia Berat	Bashkia Berat, OSHC/UNDP	2022-2025	0.00	0.00	154,000.00

2.4 Përfshirja në bordet e shkollës të përfaqësuesit nga prindërit/komuniteti Rom dhe Egjiptian	Ne cdo bord shkolle ku ka përfaqësues të komunitetit rome dhe egjiptianë do të jetë të paktën një përfaqësues i komunitetit anëtar i bordit	Shkollat	Shkollat, ZVA	2022-2025	0	0	0
2.5 Promovimi i nxënësve romë dhe egjiptianë me rezultatet më të larta në mësimet si dhe ata të cilët kanë ndjekur rregullisht shkollën	Cdo vit secila shkollë do të promovojë nxënësit R/E të cilët kanë patur rezultate të larta në mësimet si dhe kanë ndjekur rregullisht shkollën	shkollat	Bashkia Berat	2022-2025	0	0	0
2.6 Ngritja e kampeve verore me programe mesimore dhe aktivitete të ndryshme në qendrën komunitare nderkulturore	2 kampe verore të zhvilluara cdo vit me pjesëmarrjen e fëmijëve të pakicave R/E dhe të kthyerve nga emigrimi	Bashkia Berat	Bashkia Berat, OSHC lokale, organizata rome	2022-2025	0.00	0.00	1,800,000.00

Fusha e ndërhyrjes : ARSIMI DHE NXITJA E DIALOGUT NDËRKULTUROR						
<b>Objektivi Strategjik</b>	Arsimim më cilësor për anëtarë të pakicave Rome dhe Egjiptiane dhe familjeve të kthyer nga emigrimi apo azili në Bashkinë Berat					
<b>Objektivi 3</b>	Lehtësimi i aksesit në arsim të të gjitha niveleve për fëmijët romë dhe egjiptianë të kthyer nga emigrimi apo azili					
<b>Rezultatet e pritshme:</b>	i. Deri në fund të 2025, 100% e fëmijë të pakicave Rome dhe Egjiptiane të cilët kthehen nga emigrimi apo azili në bashkinë Berat kanë akses të plotë në të gjitha nivelet e arsimimit					
<b>Treguesit:</b>		Baseline 2021	Target 2022 Kumulative	Target 2023 Kumulative	Target 2024 Kumulative	Target (2025) Kumulative
	Raporti i vlerësimi i përfunduar në lidhje me identifikimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë të kthyer nga emigrimi apo azili të cilët nuk ndjekin arsimin parashkollor dhe atë të detyruar	0	1	1	1	1
	Numri i nxënësve R/E të kthyer nga emigrimi apo azili që nuk vijnë në mësimin rregullisht nevojat e të cilëve janë identifikuar dhe adresuar Ndarë sipas gjinisë, etnisë, grupmosha	0	20	30	40	50
	Numri i fëmijëve R/E të kthyer nga emigrimi apo azili të cilët janë mbështetur/lehtësuar për regjistrimin e tyre në shkollë Ndarë sipas gjinisë, etnisë, të kthyer nga emigrimi apo azili, grupmosha	7 fëmijë rom dhe egjiptiane	10	22	34	50
	Numri i programeve të dedikuara me focus nxënësit e arsimit fillor të kthyer nga emigrimi apo azili, të cilët, ndryshe nga bashkëmoshatarët e tyre: a. nuk kanë ndjekur arsimin parashkollor; nuk flasin gjuhën shqipe.	0	1	2	3	3
	Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë të kthyer nga emigrimi apo azili të cilët mbështeten me mësues shtesë Ndarë sipas gjinisë, etnisë, të kthyer nga emigrimi apo azili, grupmosha	0	15	25	34	34

	Numri i psikologëve dhe punonjësve social të dedikuar për fëmijët Romë dhe Egjiptianë të kthyer nga emigrimi	3	4	9	15	22

MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR	Financimi		
					Bashkia	Qeveria Qendrore	Donatorë
*3.1 Identifikimi i fëmijëve romë dhe egjiptianë të kthyer nga emigrimi apo azili të cilët nuk ndjekin arsimin parashkollor dhe atë të detyruar dhe krijimi i nje baze te dhenash.	Raport vlerësimi	ZVA	Bashkia Berat, OSHC	2022	0.00	0.00	200,000.00
*3.2 Identifikimi dhe adresimi i nevojave të nxënësve romë dhe egjiptianë të kthyer nga emigrimi apo azili që nuk vijnë në mësimin rregullisht	Vlersimi i nevojave	MAS	Bashkia Berat. OSHC	2022-2025	0.00	0.00	1,540,000.00
*3.3 Lehtësimi i fëmijëve të kthyer nga emigrimi apo azili për regjistrimin e tyre në shkollë	Bashkia Berat mbështet fëmijët e kthyer nga emigrimi përmes referimit në institucionet përkatëse për sigurimin e dokumentacionit të duhur për regjistrimin e tyre në shkollë. Kryerja paraprakisht e një procesi të vlerësimit të nevojave për shkollimin e fëmijëve të kthyer do të jetë pjesë e asistencës. Mbeshtetje për kryer procedurat administrative për regjistrimin në shkollë	ZVA , NJMF Bashkia Berat	UNDP	2022-2025	0.00	154,000.00	616,000.00

	femijeve qe jane kthyer nga emigrimi apo azili dhe qe per pasoje kane mangesi ne dokumentacion						
*3.4 Lehtësimi në përgatitjen e dokumentatve të nevojshme për regjistrimin në arsimin e detyruar të fëmijëve të kthyer nga emigrimi (Ketu përfshihet mbulimi I kostove të cilat lidhen me përkthimet, noterizimet dhe procesin e vulës apostile)	Cdo vit 10 fëmijë të kthyer nga emigrimi janë asistuar në përgatitjen e dokumentatve të nevojshme për regjistrimin në arsimin e detyruar	UNDP OSHC	ZVA, UNDP	2022-2025	0.00	0.00	250,000.00
*3.5 Programe të dedikuara me focus nxënësit e arsimit fillor të kthyer nga emigrimi apo azili, të cilët, ndryshe nga bashkëmoshatarët e tyre: a. nuk kane ndjekur arsimin parashkollor; b. nuk flasin gjuhën shqipe	Cdo vit 15 fëmijë të pakicave R&E kanë qenë përfitues i kurseve të dedikuara për mësimin e gjuhës shqipe	Bashkia Berat	ZVA	2022-2025	0.00	0.00	300,000.00
*3.6 Vendosja e mësuesve shtesë për fëmijët e pakicave Rome dhe Egjiptiane të kthyer nga emigrimi apo azili (këtu përfshihen mësues për mësimin e gjuhës shqipe si dhe për lëndë të tjera të domosdoshme për ecurinë e nxënësit)	Cdo vit një mësues shtesë do të asistojnë fëmijët e kthyer nga emigrimi, pas orës së mësimin, për të lehtësuar aksesin dhe mbarëvajtjen e tyre në arsimin e detyruar	ZVA	Bashkia Berat, OSHC	2022-2025	0.00	0.00	680,000.00
*3.7 Ofrimi i shërbimit të psikologut dhe punonjësit social për fëmijët Romë dhe Egjiptianë të kthyer nga emigrimi	2 punonjës (një psikolog dhe një punonjës social) do të asistojnë në mënyrë të dedikuar cdo vit fëmijët R&E të kthyer nga	Bashkia Berat	Bashkia Berat, OSHC	2022-2025	0.00	0.00	660,000.00

	emigrimi apo azili për të përballuar vështirësitë e përshtatjes						
--	---	--	--	--	--	--	--

Fusha e ndërhyrjes : ARSIMI DHE NXITJA E DIALOGUT NDËRKULTUROR							
<b>Objektivi Strategjik</b>	Arsimim më cilësor për anëtarë të pakicave Rome dhe Egjiptiane dhe familjeve të kthyer nga emigrimi apo azili në Bashkinë Berat						
<b>Objektivi 4</b>	Përmirësimi i dialogut ndërkulturor dhe mirëkuptimit të përbashkët						
<b>Rezultatet e pritshme:</b>	i. Më shumë aktivitete ndërkulturore janë zhvilluar në bashkinë Berat me pjesëmarrjen të pakicave R/E dhe ato jo –rome deri në fund të vitit 2025						
<b>Treguesit:</b>		Baseline 2021	Target 2022 Kumulative	Target 2023 Kumulative	Target 2024 Kumulative	Target (2025) Kumulative	
	Numri i aktiviteteve të kryera për adresimin e barrierave sociale etj.). Ndare sipas llojit të aktivitetit : aktivitete lokale social-kulturore, konkurse etj.	0	1	2	3	3	
	Numri i burrave dhe grave (të kthyerit, anëtarët e familjes dhe fqinjët) që përfitojnë nga aktivitetet e bazuara në komunitet që promovojnë kohezionin social.	0	180	420	540	540	
MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR	Financimi		
					Bashkia	Qeveria Qendrore	Donatorë
4.1 Promovimi i talentëve nga komuniteti Rom dhe Egjiptian në këngë, instrumenta muzikore, zeje nëpërmjet përfshirjes së tyre në aktivitete lokale social-kulturore, konkurse etj.	Individë rome dhe egjiptianë të promovuar	Bashkia	Media lokale bashkia, organizata rome dhe egjiptiane	2022-2025	0.00	0.00	150,000.00
4.2 Aktivitete promovuese të kultures dhe gjuhës Rome, në kuader të Diteve të kultures Rome dhe Egjiptiane		Bashkia	Media lokale, organizata rome dhe egjiptiane, I/NGO të tjera, UNDP		0.00	0.00	2,700,000.00

4.3 Informimi dhe ndërjegjësimi i popullatës shumicë për kulturën rome dhe egjiptiane	Fushata informimi, informacione në faqen e bashkisë , programe në televizionet lokale	Bashkia Berat, OSHC	Media lokale	2022-2025			
4.4 Organizimi i panairëve me punimet artistike të komunitetit Rom dhe Egjiptian të zhvilluara në Qendrën komunitare Nderkulturore.	Panaire	Bashkia Berat	UNDP, OSHC	2022-2024			

Fusha e ndërhyrjes : STREHIMI						
Objektivi Strategjik	Përmirësimi i gjendjes së vendbanimeve të pakicave R&E dhe familjeve të kthyer nga emigrimi në Bashkinë Berat					
Objektivi 1:	Përmirësimi i kushteve në banesat dhe infrastrukturën ekzistuese të minoritetëve R&E në Bashkinë Berat					
Rezultatet e pritshme:	i. Deri në fund të vitit 2025 80% e popullsisë rome dhe egjiptiane në bashkinë Berat do të përfitojnë nga përmirësimi i kushteve të banesave dhe infrastruktures ekzistuese					
Treguesit:		Baseline 2021	Target 2022 Kumulative	Target 2023 Kumulative	Target 2024 Kumulative	Target (2025) Kumulative
	Lista së të pastrehëve të familjeve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Berat ka përfunduar	1	1	1	1	1
	Numri i familjeve rome dhe egjiptiane të identifikuar si të pastreha Të ndara sipas etnisë dhe familje të kthyer nga emigrimi apo azili	140 familje	130 (jo cumulative)	140	150	160
	Sigurimi i nje strehimi afatgjat brenda kushteve te 20 familjeve në zonën e Ish Peshkores.  Kosotja strehimit nepermjet bonusit te qerese nje banese 12,000 leke qeraje ne muaj	0	0	5 familje	15 familje	20 familje
	Kanalizimet në zonat me popullsi R&E pikërsiht në zonën Donika Kastrioti, Otlak , Uznove kanë përfunduar.	0	0	0	1	1
	Rregullimi i rrugëve të brendshme dhe ndricimit në rrugët e lagjeve Stan Moranë, Ish- Peshkore, Uznovë ka përfunduar	0	0	0	1	1

Rikonstruksioni i tregut ne Lagjen nr. 1 për shitjen e rrobave të përdorura e dedikuar edhe per komunitetin R/E dhe funksionimi i rij brenda standardeve.	0	0	0	1	1
Numri i pakicave R/E të cilët kanë përfituar asistencë për arsye se kanë probleme dokumentacioni/regjistrimi për aksesimin e shërbimeve  Ndarë sipas : etnisë, të kthyer nga emigrimi apo azili, gjinisë, grupmoshës	0	50	70	100	110
**Numri i familjeve Rome dhe Egjiptiane që përfitojnë nga programi i permiresimit te banesave ekzistuese, nepermjet granteve konkurruese qe u akordohen NJVV  Të ndara sipas etnisë dhe familje të kthyer nga emigrimi apo azili	6 familje Egjiptiane	7 familje (2 Rome, 5 Egjiptiane)	15	24	34
**Numri i familjeve rome dhe egjiptiane te cilat kane perfituar nga programi i zhvillimit te zones me qellim strehimin, ku perfshihet dhe permiresim i infrastruktures  Të ndara sipas etnisë dhe familje të kthyer nga emigrimi apo azili  Ne total në gjithë qytetin e Beratit jane 323 familje rome dhe 3610 familje egjiptiane,. Ne total 3933 familje R/E. 70 % e totalit te ketyre familjeve kane perfituar nga programi i zhvillimit te zones me qellim strehimin, ku perfshihet dhe permiresim i infrastruktures	2,753 familje	2780	2850	2910	3200
**Numri i raporteve vjetore te dorezuara nga bashkia Berat prane MFE ne kuader të vlerësimit mbi zbatimin dhe progresin e arritur ne programin e strehimit	1	1	1	1	1
**Numri i familjeve rome dhe egjiptiane që përfitojnë nga shërbimet shtesë në rastet e pamundësisë për të paguar detyrimet financiare për një program strehimi.shtuar edhe subvneccionimi i qerase  Të ndara sipas etnisë dhe familje të kthyer nga emigrimi apo azili	16 familje ne total, ku 15 janë egjiptiane dhe 1 familje Rome	22 familje ne total	50	75	100

<b>MASAT DHE AKTIVITETET</b>	<b>PRODUKTI</b>				<b>Financimi</b>
------------------------------	-----------------	--	--	--	------------------



		<b>INSTITUCIONI PËRGJEGJËS</b>	<b>INSTITUCIONET PARTNERE</b>	<b>AFATI KOHOR</b>	Bashkia	Qeveria Qendrore	Donatorë
1.1. Hartimi i listës së të pastrehëve të familjeve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Berat(dhe azhornimi mbi baza vjetore i saj)	Lista e të pastrehëve e hartuar . Këtu përfshihen të gjitha familjet në zonat “ Donika Kastrioti, Otlak, Ish Peshkorja, Stan Moranë, Moravë, Uznovë	Zyra e strehimit në Bashki	Bashkia Berat	2022	184,800.00	0.00	0.00
1.2 Vlerësimi i nevojave dhe identifikimi i banesave që kanë nevojë për ndërhyrje,	Vlerësimi i banesave	Zyra e strehimit në Bashki	Bashkia Berat	2022	61,600.00	0.00	0.00
R1.2.1 Rikonstruksioni i banesave të 20 familjeve në zonën e Ish Peshkores.	Nder vite asnje familje R/E nuk ka perfituar në këtë zonë nga rikonstruksioni i banesave. Jane 20 familje te cilat kane nevoje per nderhyrje emergjente per rikonstruksion.	Bashkia Berat	MFE, Bashkia Berat	2023-2025	18,000,000.00	0.00	0.00
1.3 Rehabilitimi dhe sistemimi i kanalizimeve në zonat me popullsi R&E pikërisht në zonën Donika Kastrioti, Otlak , Uznove.  (Në këto zona ka demitime te mëdha të kanalizimeve të cilat ndonjëherë cojnë në probleme sanitare për komunitetin R/E . Në zonen Donika Kastrioti shtepite e nderuara gjate viteve 1960 jane shume te vjetra. Gjate dimrit e gjithe zona permbytet nga ujrat e zeza. Ka probleme sanitare. Në këtë zonë impaktohen 300 familje – 5 familje rome dhe 295 familje egjiptiane)	Kanalizime të rehabilituara bë Donika Kastrioti, Otlak , Uznove.  Gjatë vitit 2021 Bashkia Berat, ka qene perfituese nga projekti nga KfV per rehabilitimin e ujrave te bardha dhe te zeza ne te gjithe territorin e saj	Bashkia Berat	MFE Bashkia Berat	2022-2025	3,752,019.00	0.00	0.00

1.6 Rregullimi i rrugëve të brendëshme dhe ndricimit në rrugët e lagjeve Stan Moranë, Ish-Peshkore, Uznovë	Rregullimi i sistemit të ndricimit	Bashkia Berat	Bashkia Berat	2023			
1.7 Vendosija e kontenierëve të mbeturinave brenda lagjeve të zonës Otlak	Zona Otlak është pajisur me kontenierë për hedhjen e mbeturinave	Bashkia Berat	Bashkia Berat	2023	870,000.00	0.00	0.00
1.8 Rikonstruksioni i tregut pranë Lagjes No1 brenda standarteve për shitjen e rrobave të përdorura e dedikuar edhe për komunitetin R/E	Tregu i shitjes së rrobave i ngritur në Ish - Peshkore	Bashkia Berat	Bashkia Berat, OSHC, UNDP	2024	2,250,000.00	0.00	5,250,000.00
1.9 Sigurimi i asistencës juridike për anëtarët e minoriteteve R&E dhe ata të kthyer nga emigrimi apo azili që kanë probleme dokumentacioni/regjistrimi për aksesimin e shërbimeve	Sigurim asistence juridike	Bashkia Berat	Bashkia Berat, OSHC, UNDP	2022	0.00	0.00	550,000.00

<b>Fusha e ndërhyrjes : STREHIMI</b>						
<b>Objektivi Strategjik</b>	Përmirësimi i situatës së strehimit të pakicave R&E dhe familjeve të kthyer nga emigrimi në Bashkinë Berat, përmes ndërhyrjeve të qëndrueshme.					
<b>Objektivi 2:</b>	Më shumë familje romë dhe egjiptiane dhe atyre të kthyer nga emigrimi janë përfshirë në programet e strehimit social					
<b>Rezultatet e pritshme:</b>	Deri në fund të vitit 2025, 50% më shumë familje R&E do të regjistrohen në skemat e strehimit krahasuar me numrin e familjeve përfituese në vitin 2022					
<b>Treguesit:</b>		Baseline 2021	Target 2022 Kumulative	Target 2023 Kumulative	Target 2024 Kumulative	Target (2025) Kumulative
	**Bashkia Berat ka aplikuar dhe përfituar financime në MFE për përmirësimin e kushteve të jetesës së pakicave romë dhe egjiptiane	1	1	1	1	1
	**Bashkia Berat ka miratuar planin 5 vjeçar të strehimit	0	0	0	1	1
	**Numri i vendbanimeve të legalizuara që posedohen nga romë dhe egjiptiane	250 vendbanime	260	540	800	1100
	Numri i banesave R/E të identifikuar për formalizim .	20 banesa	26 banesa	52	80	110 banesa
	Ndarë sipas: etnisë, familje të kthyer nga emigrimi apo azili					
	Numri i familjeve R/E të cilët kanë marrë asistencë për plotësimin e dokumentacionit në programet e strehimit social	100 familje	110	220	350	500
	Ndarë sipas : etnisë, të kthyer nga emigrimi					

MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR	Financimi		
					Bashkia	Qeveria Qendrore	Donatorë
**2.1 Ofrimi i ndihmës për familjet rome dhe egjiptiane edhe ata të kthyer nga emigrimi që nuk kanë mundësi të paguajnë qiranë e strehimit social si dhe ato që kanë përfituar apo do të përfitojnë nga subvencionimi i qerave dhe ofrimi i kredisë së subvencionuar (përfshirë, pa kufizime, negocimin e planeve të pagesës, referimin për punësimin dhe shërbimet e tjera përkatëse) (Përfshirë ketu edhe 20 familje R/E në Uznove, lagjia Zagore)	X familje R&E përfshirë dhe ato të kthyer nga emigrimi janë përfshirë në skemat e strehimit	Bashkia Berat Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Bashkia Berat, komuniteti	2022-2025	0.00	2,250,000.00	0.00
2.2 Identifikimi i rasteve për formalizim (regjistrim) të banesave të ndërtruara në mënyrë jo-ligjore/të parregullt	Familje të identifikuara për formalizim të banesave	Bashkia Berat	Bashkia Berat	2022-2025	1,100,000.00	0.00	0.00
2.3 Ofrimi i Asistencës për legalizimin e banesave për : 2 familje në Otlak; 10 familje në Donika Kastrioti; 7 familje në ish-Peshkore	Asistencë për fillimin e procesit të legalizimit për banesat ende të palegalizuara	Bashkia Berat	Bashkia Berat	2024	0.00	0.00	190,000.00
2.4 Sigurimi i kontratave me OSHE të familjeve rome dhe egjiptiane të cilat kanë hyrë në proces legalizimi të banesave të tyre	Familje Rome/Egjiptiane të cilat nuk kanë kontratë me OSHE janë pa energji elektrike	Bashkia Berat	Bashkia Berat, Organizata rome, përfaqësues të pakicave	2022	0	0	0
2.5 Vijimi i përcaktimit të kuotave (%) për R&E në përfitimin nga banesat sociale (përfshi lehtësimin e procedurave/kushteve).	Përcaktimi i kuotave për familjet R&E për përfitimin nga banesat sociale (përfshi lehtësimin e procedurave/kushteve).	Bashkia Berat	Bashkia Berat	2022-2025	0	0	0
2.6 Takime informuese rreth programeve të strehimit social dhe procedurave të aplikimit në këto programe për pakicat R&E dhe të kthyerve	Takime në komunitet, informacion në rrjetet sociale, faqja e bashkisë	Bashkia Berat, Drejtoria e shërbimeve sociale, Drejtoria e Srehimit social	Bashkia Berat	2022-2025	616,000.00	0.00	0.00

2.7 Ofrim asistence për plotësimin e dokumentacionit në programet e strehimit social	Vendosja e një personi të dedikuar për të asistuar në plotësimin e dokumentave për aplikim në programet e strehimit social per pakicat R&E	Bashkia Berat, Drejtoria e sherbimeve sociale , Drejtoria e Srehimit social	Bashkia Berat	2022-2025	2,500,000.00	0.00	0.00
--	--	---	---------------	-----------	--------------	------	------

Fusha e ndërhyrjes : STREHIMI						
<b>Objektivi Strategjik</b>	Përmirësimi i situatës së strehimit të pakicave R&E dhe familjeve të kthyer nga emigrimi në Bashkinë Berat, përmes ndërhyrjeve të qëndrueshme.					
<b>Objektivi 3:</b>	Përmirësimi i kushteve të strehimit të familjeve romë dhe egjiptiane të kthyer nga emigrimi apo azili					
<b>Rezultatet e pritshme:</b>	Deri në fund të vitit 2025, 40% me shumë familje romë dhe egjiptiane të kthyer nga emigrimi apo azili kanë përmirësuar kushtet e banimit në krahasim me numrin e familjeve të raportuara në vitin 2022					
<b>Treguesit:</b>		Baseline 2021	Target 2022 Kumulative	Target 2023 Kumulative	Target 2024 Kumulative	Target (2025) Kumulative
	Numri i takimeve informuese informuese rreth programeve të strehimit social dhe procedurave të aplikimit në këto programe me pjesëmarrjen e pakicave R&E të kthyer nga emigrimi	10 takime	12 takime	25 takime	40 takime	55 takime
	Numri i familjeve R/E të kthyer nga emigrimi apo azili të cilët kanë përfituar nga subvencionimi i qerave dhe ofrimi i kredisë së subvencionuar (përfshirë, pa kufizime, negocimin e planeve të pagesës, referimin për punësimin dhe shërbimet e tjera përkatëse)	2 familje	3	7	12	19
	Numri i familjeve R/E të kthyer nga emigrimi të cilat janë informuar rreth programeve të strehimit social dhe procedurave të aplikimit në këto programe	20 familje	25	50	75	90
	Numri i familjeve R/E të kthyer nga emigrimi apo azili të cilët kanë përfituar asistence për plotësimin e dokumentacionit në programet e strehimit social	20 familje	25	50	75	90

MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI				Financimi
-----------------------	----------	--	--	--	-----------

		<b>INSTITUCIONI PËRGJEGJËS</b>	<b>INSTITUCIONET PARTNERE</b>	<b>AFATI KOHOR</b>	Bashkia	Qeveria Qendrore	Donatorë
*3.1 Subvencionimi i qerases dhe ofrimi i kredisë së subvencionuar (përfshirë, pa kufizime, negocimin e planeve të pagesës, referimin për punësimin dhe shërbimet e tjera përkatëse) për familjet R&E të kthyer nga emigrimi dhe azili me probleme në strehim.	X familje R&E të kthyer nga emigrimi janë përfshirë në skemat e strehimit	Bashkia Berat Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Bashkia Berat, komuniteti	2022- 2025	142,500.00	142,500.00	0.00
*3.2 Identifikimi i rasteve të familjeve R/E të kthyer nga emigrimi për formalizim (regjistrim) të banesave të ndërtuara në mënyrë jo-ligjore/të parregullt	Familje të identifikuar për formalizim të banesave	Bashkia Berat	Bashkia Berat	2022- 2025	0.00	0.00	184,800.00
*3.3 Përcaktimi i kuotave (%) për familjeve romë dhe egjiptiane të kthyer nga emigrimi apo azili në përfitimin nga banesat sociale (përfshi lehtësimin e procedurave/kushteve).	Percaktimi i kuotave për familjet R&E të kthyer nga emigrimi për përfitimin nga banesat sociale (përfshi lehtësimin e procedurave/kushteve).	Bashkia Berat	Bashkia Berat	2022- 2025	0	0	0
*3.4 Takime informuese rreth programeve të strehimit social dhe procedurave të aplikimit në këto programe për pakicat R&E të kthyer nga emigrimi	Takime në komunitet, informacion në rrjetet sociale, faqja e bashkisë	Bashkia Berat, <i>Drejtoria e shërbimeve sociale , Drejtoria e Srehimit social</i>	Bashkia Berat	2022- 2025	0.00	0.00	500,000.00
*3.5 Ofrim asistence për plotësimin e dokumentacionit në programet e strehimit social për familjet R/E të kthyer nga emigrimi	Vendosja e një personi të dedikuar për të asistuar në plotësimin e dokumentave për aplikim në programet e strehimit social për pakicat R&E	Bashkia Berat, <i>Drejtoria e shërbimeve sociale , Drejtoria e Srehimit social</i>	Bashkia Berat	2022- 2025	Eshte pershire ke 2.7		

**Fusha e ndërhyrjes : PUNËSIMI DHE FUQIZIMI EKONOMIK**

<b>Objektivi Strategjik</b>	Më shumë të punësuar nga pakicat R&E përfshirë edhe R&E të kthyer nga emigrimi dhe azili në Bashkinë Berat, përmes ndërhyrjeve për kualifikime dhe punësim të tyre
<b>Objektivi 1:</b>	Informimi dhe lehtësimi i aksesit ndaj shërbimeve të punësimit dhe tregut të punës
<b>Rezultatet e pritshme:</b>	i. Deri në fund të 2025, 40% me shume anëtarë të pakicave shume romë dhe egjiptiane në Bashkinë Berat kanë aksesuar shërbimet e punësimit dhe të tregut të punës në krahasim me vitin 2022

Treguesit:		Baseline	Target	Target	Target	Target (2025) kumulativ
		2021	2022 kumulativ	2023 kumulativ	2024 kumulativ	
	Dokumenti mbi profilin e PuPa për pakicat R/E i finalizuar	0	0	1	1	1
	Numri i R/E të papunë dhe të përgjistruar në zyrën e punës të identifikuar Ndarë sipas: Gjinisë, etnisë, i kthyer nga emigrimi	Nuk ka te dhena	30	60	90	120
	Numri i takimeve të dedikuara me komunitetin e biznesit për të promovuar Romë dhe egjiptianë të arsimuar dhe të aftë profesionalisht me qëllim punësimin e tyre	0	4	8	10	10
	Numri i bizneseve që kanë marrë pjesë në takime të dedikuara me biznesin për të promovuar Romë dhe egjiptianë të arsimuar dhe të aftë profesionalisht me qëllim punësimin e tyre	0	8	15	21	27
	Numri i R/E të cilët kanë përfituar nëpërmjet ofrimit të granteve të vogla/ dhe shërbimeve mbështetëse (trajnime për sipërmarrjen dhe përgatitjen e planit të biznesit) me qëllim akomodimin e tyre në ekonominë formale : Ndarë sipas gjinisë, etnisë, të kthyer nga emigrimi apo azili, moshë Referohi ind 2.2.1 tek prodoku	0	3	7	10	10
	Numri i të kthyerve të papunë të punësuar në bizneset e reja të hapura nga të kthyerit	0	3	10	13	13
	Vendim i Këshillit Bashkiak i aprovuar i cili formalizon kuotat që mundësojnë punësimin e romëve dhe egjiptianëve në administratën publike në nivel vendor (arsim, shëndetësi, bashki etj)	0	0	1	1	1
	Numri i pakicave R/E dhe të kthyerve nga emigrimi dhe azili që zotërojnë shkollim/kualifikim profesional të cilët marrin mbështetje të personalizuar për aplikime për punëkërkim	0	15	35	55	55

MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR	Financimi		
					Bashkia	Qeveria Qendrore	Donatorë
1.1 Profilizimi i individëve Punëkërkuar të Papunë te pakicave R/E në Bashkinë Berat	Hartimi i nje dokumenti mbi profilin e PuPa nga pakicat R/E	Zyra e Punëkërkuarve (ZPK) Berat	Bashkia Berat	2022	0.00	0.00	400,000.00
1.2 Identifikim i të gjithë R/E të papunë dhe të përgjithshme në zyrën e punës dhe vleresim i nevojave për punësim dhe kualifikim të tyre (Asnje grua rome ne zonen Otlak nuk eshte e punesuar. Asnje prej tyre nuk eshte e regjistruar si Punekekruese e Papune. Jane rreth 50 gra rome te papuna)	Të dhëna të sakta mbi R/E të Papunë dhe të përgjithshme në zyrën e punës. Raport vleresimi ne lidhje me nevojat per punesim dhe kualifikim	Zyra e Punëkërkuarve (ZPK) Berat	Bashkia Berat, OSHC vendore	2022	0.00	0.00	277,200.00
1.3 Fushatë informuese per R./E mbi programet e punësimit	Materiale informuese te cilat janë të thjeshta për tu kuptuar nga pakicat R/E	Zyra e Punëkërkuarve (ZPK) Berat	Bashkia Berat	2022-2025	0.00	0.00	1,000,000.00
1.4.Sensibilizimi i bizneseve në Bashkinë Berat dhe komunitetit në tërësi me qëllim që të jenë më të hapur dhe jo-paragjykyes ndaj anëtarëve të pakicave R&E në lidhje me çështje të punësimit	Takime të dedikuara me komunitetin e biznesit për të promovuar Romë dhe egjiptianë të arsimuar dhe të aftë profesionalisht me qëllim punësimin e tyre.	Bashkia Berat	OSHC, Zyra e Punëkërkuarve (ZPK) Berat	2023	0.00	0.00	2,402,400.00
1.5 Aktivitete ndërgjegjësuere me punëdhënës/biznese aktive në Bashkinë Berat, mbi punësimin e R&E dhe vecanerisht atyre të kthyer nga emigrimi dhe azili të cilët kane aftesi profesionale të fituar në emigrim	Takime me bizneset lokale ne lidhje me ceshtje të punësimit rë R&E dhe vecanerisht atyre të kthyer nga emigrimi të cilët kane aftesi	Bashkia Berat	OSHC, Komuniteti i biznesit	2022-2025			

	profesionale të fituar në emigrim						
1.6 Vetëpunësimi dhe sipërmarrja e romëve dhe egjiptianëve mbështetet nëpërmjet ofrimit të granteve të vogla/kreditë e buta dhe shërbimeve mbështetëse (trajnime për sipërmarrjen dhe përgatitjen e planit të biznesit) me qëllim akomodimin e tyre në ekonominë formale.	Grande te vogla / kredi të buta	Zyra e Punëkërkesve (ZPK) Berat	Bashkia Berat	2022-2025	0	0	0
1.7 Formalizimi i kuotave që mundësojnë punësimin e romëve dhe egjiptianëve në administratën publike në nivel vendor (arsim, shëndetësi, bashki etj)	Vendim i Këshillit Bashkiak	Këshilli Bashkiak	Bashkia Berat	2022	0	0	0
1.8 Bashkia Berat i ofron emigrantëve potencialë njohuri për tregjet e punës, kërkimin e punës dhe kërkesat për aftësi në vendet e destinacionit	Informacion i publikuar në ëebsite e bashkisë ose në rrjete sociale mbi tregjet e punës në vendet e destinacionit	Bashkia Berat	Bashkia Berat, OSHC lokale	2022-2025	0.00	0.00	123,200.00
1.9 Mbështetje e personalizuar për aplikime për punëkërkim tek anëtarët e pakicave R&E dhe atyre të kthyer nga emigrimi dhe azili që zotërojnë shkollim/kualifikim profesional.	Referimi dhe ofrimi i shërbimeve të personalizuara nëpërmjet intervistimit, profilizimit dhe hartimit të planit individual(Ref ligjore: VKM 837, date 28.10.2020 “Për procedurat, kriteret e rregullat për ofrimin e shërbimeve të punësimit” VKM 17, datë 15.1.2020, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe	Bashkia Berat	Zyra e Punëkërkesve (ZPK) Berat	2022-2025	0.00	0.00	39,000.00



	praktikave profesionale” I ndryshuar						
--	--------------------------------------	--	--	--	--	--	--

Fusha e ndërhyrjes : PUNËSIMI DHE FUQIZIMI EKONOMIK						
<b>Objektivi Strategjik</b>	Më shumë të punësuar nga pakicat R&E përfshirë edhe R&E të kthyer nga emigrimi dhe azili në Bashkinë Berat, përmes ndërhyrjeve për kualifikime dhe punësim të tyre					
<b>Objektivi 2:</b>	Krijimi i mekanizmave të reja nxitës për punëdhënësit me qëllim rritjen e punësimit të pakicave R&E dhe të kthyerve nga emigrimi apo azili					
<b>Rezultatet e pritshme:</b>	i.					
<b>Treguesit:</b>		Baseline 2021	Target 2022 Kumulative	Target 2023 Kumulative	Target 2024 Kumulative	Target (2025) Kumulative
	Bashkia Berat aprovon VKB për reduktimin e taksave vendore ose i tarifave vendore (përgjithmonë ose perkoheisht) për subjekte të cilat kanë punësuar anëtarë të pakicave R&E osë të kthyer nga emigrimi ose azili;	0	0	1	1	1
	Numri i romëve dhe egjiptianëve të punësuar në subjekte të cilat kanë përfituar nga reduktimi i taksave vendore ose i tarifave vendore (përgjithmonë ose perkoheisht) për arsye se kanë punësuar anëtarë të pakicave R&E osë të kthyer nga emigrimi ose azili. Ndarë sipas gjinisë, etnisë, të kthyer nga emigrimi apo azili, mosha	0	5	10	15	20
	Zbatimi i programit kombëtar të daljes për përfituesit e ndihmës ekonomike	0	1	1	1	1
	Numri i familjeve R/E të cilat janë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike  Ndarë sipas: Etnisë, të kthyer nga emigrimi	50	60	120	200	200
	Numri i R/E të cilët të cilët janë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike dhe që kanë përfituar nga funksionimi i nismës të punëve në komunitet – investime publike, duke i përfshirë ata në këto projekte. Ndarë sipas gjinisë, etnisë, të kthyer nga emigrimi apo azili, mosha	0	100	105	210	320

Bashkia Berat ka miruaruar VKB e cila ka për qëllim të ulë taksat dhe tarifat për bizneset e ngritura nga romët dhe egjiptianët	0	0	1	1	1
**Vendimi i Këshillit Bashkiak i cili redukton ose përjashton nga tarifat romët dhe egjiptianët ambulantë, që tregëtojnë produkte artizanale ose mallra dhe shërbime të tjera, për një periudhë të paracaktuar është aprovuar dhe vazhdon të zbatohet.	1	1	1	1	1
**Numri i romëve dhe egjiptianëve të pajisur me leje për zhvillimin e aktiviteteve ambulatorë në hapësirat publike dhe të përjashtuar/reduktuar nga tarifat financiare. Ndarë sipas gjinisë, etnisë, të kthyer nag emigrimi apo azili, mosha	30	45	60	80	100
Numri i hapësirave tregëtare të caktuar të përdorur nga romët dhe egjiptianët.	1	1	1	1	1
**Krijimi i një pakete të veçantë që mbështet, favorizon dhe lejon grumbulluesit romë dhe egjiptianë të materialeve të riciklueshme të ushtrojnë aktivitetin e riciklimit direkt në burim (familjet, zyrat, bizneset etj.) sipas rregullave të standardizuara.	0	1	1	1	1
Numri i programeve inovative per start-up-e duke i dhënë prioritet bizneseve që ruajnë traditat e pakicave R&E ( si artizan : kovacane, hekurthyes, prodhues shportash me thurje). Ndarë sipas llojit të programeve	0	2	3	4	5
Numri i romëve dhe egjiptianëve që kanë përfituar nga këshillime, seancave mentoruese dhe shërbimeve per zhvillimin e biznesit per bizneset e ngritura prej tyre përfshirë kovacanet hekurthyesit, prodhuesit e shportave me thurje). .  Ndarë sipas gjinisë, etnisë, të kthyer nag emigrimi apo azili, mosha  (Ky indikator është i njëjti me me indikatorin e ROMALB : **Numri i romëve dhe egjiptianëve përfitues prej bizneseve start up apo inisiativave ekonomike.	0	3	6	8	8

	Punishtja e artizanatit për kovacanet dhe hekurthyesit është hapur dhe funksionale	0	0	1	1	1
	Numri i R/E të përfshirë në punishten e artizanatit. Ndarë sipas gjinisë, etnisë, të kthyer nga emigrimi apo azili, mosha	0	0	20	30	40
	Mekanizmi digital me qëllim promovimin e produkteve artizane dhe me gjerë i krijuar dhe funksional	0	0	1	2	2
	Numri i R/E të papunë të cilët kanë përfituar nga programet e nxitjes së punësimit. Ndarë sipas gjinisë, etnisë, të kthyer nga emigrimi apo azili, mosha	7	8	16	25	35
	Kurrikula të reja të cilat kanë lidhje me punën artizane për kovacanet , hekurthyesit dhe shprotari të përfshira kurikulat e formimit profesional	0	0	1	1	1
	Numri i grave dhe vajzave rome egjiptiane te specializuara permes kurseve profesionale per sherbime brenda ne familje brenda standarteve. Ndare sipas : Etnise, tekthyer nga emigrimi	10	20	30	40	50

MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR	Financimi		
					Bashkia	Qeveria Qendrore	Donatorë
**12.1 Incentiva nxitëse të Bashkisë Berat me qëllim që bizneset sociale të punësojnë një numër të konsiderueshëm të pakicave Rome dhe Egjiptiane përfshirë edhe ata të kthyer nga	Reduktim i taksave vendore ose i tarifave vendore (përgjithmonë ose perkohesisht) për subjekte të cilat kanë punësuar anëtarë të pakicave R&E osë të kthyer nga emigrimi ose azili; 50 romë dhe egjiptian janë punësuar cdo vit pranë bizneseve që kanë përfituar uljen e taksave për shkak të punësimit të pakicave deri ne fund të vitit 2025	Bashkia Berat	Bashkia Berat	2022-2025	9,240.00	0.00	0.00

<sup>1</sup> Me dy yje "\*\*\*" jane te gjitha masat te cilat jane ne Planin Kombetar per Integrimin e Pakicave R/E dhe qe jane detyrim per tu implemntuar / raportuar nga NJVV

<p>emigrimi dhe azili (p.sh lehtësime në taksat vendore/ tarifatat vendore etj.) Vendorsja e kuotave në projekte të investimeve publike për marrjen në punë të anëtarëve të komunitetit rom dhe egjiptian dhe atyre të kthyer nga emigrimi dhe azili të cilët kanë aftësi profesionale.</p>							
<p>2.2 Hartimi dhe mirë funksionimi i nismës të punëve në komunitet – investime publike, me qëllim përfshirjen në to të romëve dhe egjiptianëve të cilët janë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike dhe hartimi i PIV (planit individual të veprimt)</p>	<p>Zbatimi i programit kombëtar të daljes për përfituesit e ndihmës ekonomike; (<a href="http://qeverisjavevendore.gov.al/keshillikonsultativ/ep-content/uploads/2021/01/16.-Programi-Kombetar-per-daljen-nga-skema-e-ndihmes-ekonomike.pdf">http://qeverisjavevendore.gov.al/keshillikonsultativ/ep-content/uploads/2021/01/16.-Programi-Kombetar-per-daljen-nga-skema-e-ndihmes-ekonomike.pdf</a> (2020-2022 dhe sipas rinovimit të këtij plani)</p>	<p>Bashkia Berat</p>	<p>Bashkia Berat, komuniteti i biznesit</p>	<p>2022-2025</p>	<p>0</p>	<p>0</p>	<p>0</p>
<p>2.3 Miratim nga Bashkia Berat I vendimit për uljen e taksave dhe tarifatat vendore me 50</p>	<p>Bashkia Beratka ulur taksat dhe tarifatat për bizneset e ngritura nga romët dhe egjiptianët.</p>	<p>Bashkia Berat</p>	<p>Bashkia Berat</p>	<p>2022</p>	<p>0</p>	<p>0</p>	<p>0</p>

për qind për bizneset e ngritura nga romë dhe egjiptianë, duke ju dhene prioritet te kthyerve nga emigrimi apo azili							
**2.4 Bashkia Berat redukton ose përjashton nga tarifat romët dhe egjiptianët ambulante, që tregëtojnë produkte artizanale ose mallra dhe shërbime të tjera, për një periudhë të paracaktuar	Vendimi i Këshillit Bashkiak për reduktimin e tarifave	Bashkia Berat	Bashkia Berat	2022	0	0	0
**2.5 Rezervim i hapësirave të caktuara tregëtare dhe pajisja me infrastrukturën e nevojshme për t'u përdorur nga romët dhe egjiptianët për shitjen e mallrave dhe produkteve të ndryshme.	Hapësira të caktuara tregëtare të dedikuara për R&E	Bashkia Berat	Bashkia Berat	2022-2025	0	0	0
**2.6 Formalizimi i aktivitetit të grumbulluesëve individualë romë dhe egjiptianë të mbetjeve të	Bashkia Berat realizon një studim mbi pozicionin e grumbulluesëve të mbetjeve të riciklueshme si dhe ka hartuar 1 paketë që favorizon dhe lejon grumbulluesit romë dhe egjiptianë të materialeve të riciklueshme të ushtrojnë aktivitetin e riciklimit direkt në burim	Bashkia Berat	Bashkia Berat	2022-2025	0	0	0

riciklueshme nepermjet mbështetjes financiare dhe përcaktimi i masave për integrimin e tyre gradual në sektorë të tjerë punësimi. 150 familje ushqehen me riciklimin e mbetjeve. Femijet e ketyre familjeve e braktisin shkollën dhe përfshihen në riciklim							
2.7 Mbështetja/ lehtësimi i procedurave të regjistrimit të aktiviteteve prodhuese të anëtareve të pakicave R&E përfshirë dhe ata të kthyer nga emigrimi ose azili (me qëllim mundësimin e sigurimeve shoqërore/ shëndetësore, aksesin në kredi etj).	Bizneset rome dhe egjiptiane të regjistruara në QKB	Bashkia Berat	Bashkia Berat	2022-2025	0.00	0.00	616,000.00
